

VENDIM
Nr. 726, datë 20.10.2016

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
FRANCËS, PËR PUNËSIMIN ME PAGË TË ANËTARËVE TË FAMILJEVE TË
PUNONJËSVE TË MISIONEVE ZYRTARE TË SECILIT SHTET NË SHTETIN
TJETËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Francës, për punësimin me pagë të anëtarëve të punonjësve të misioneve zyrtare të secilit shtet në shtetin tjetër, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS FRANCEZE NË LIDHJE ME PUNËSIMIN ME PAGË TË ANËTARËVE TË
FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË MISIONEVE ZYRTARE TË SECILIT SHTET NË SHTETIN
TJETËR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Francës, më poshtë të quajtura “Palët”,

duke marrë në konsideratë interesin për t’u lejuar anëtarëve të familjeve në ngarkim të punonjësve të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore të dërguara me mision zyrtar në territorin e Palës tjetër, për të ushtruar lirisht aktivitete profesionale, në bazë të një trajtimi reciprok;

me dëshirën për të lehtësuar ushtrimin e një aktiviteti profesional me pagë për anëtarët e familjeve në shtetin pritës;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Autorizim për të ushtruar aktivitete me pagë

Personat në ngarkim të personelit diplomatik, konsullor, teknik dhe administrativ të caktuar me mision zyrtar nga qeveria e tyre në shtetin tjetër janë të autorizuar të ushtrojnë një veprimtari profesionale me pagë në shtetin pritës, në të njëjtat kushte me shtetasit e atij shteti, me kusht që të respektojnë ligjet dhe rregullat për ushtrimin e profesionit të tyre, me të marrë autorizimin e kërkuar në përputhje me çka parashikohet në këtë marrëveshje.

Neni 2

Përkufizime

Kuptimet e shprehjeve sipas kësaj marrëveshjeje janë si më poshtë:

a) Termi “misione zyrtare” do të thotë misionet diplomatike të rregulluara nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike, e 18 prillit 1961, postet konsullore të rregulluara nga Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore, e 24 prillit 1963, dhe përfaqësitë e përhershme të secilit prej dy shteteve pranë organizmave ndërkombëtarë që kanë nënshkruar marrëveshje selie me shtetin tjetër;

b) Termi “anëtar i një misioni zyrtar” do të thotë: personel i shtetit dërgues, që nuk është as shtetas, as rezident i përhershëm në shtetin pritës, që ka funksion zyrtar në një mision diplomatik, në një post konsullor ose në një përfaqësi të përhershme të shtetit dërgues në shtetin tjetër.

c) Termi “person në ngarkim”, do të thotë:

Për Palën Shqiptare:

1. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët, të cilët janë pjesë e përhershme e familjes së anëtarit të misionit diplomatik apo posteve konsullore në shtetin pritës.

Për Palën Franceze:

1. Bashkëshorti/ja i/e të njëjtut seks ose me seks të ndryshëm ose partneri i lidhur me një kontratë bashkimi civil, me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze;

2. Fëmijët beqarë më të vegjël se 21 vjeç, që jetojnë në ngarkim të prindërve dhe në të njëjtën banesë, përfshirë këtu dhe ata që ndjekin studimet në shkolla të larta të njohura nga secili shtet, me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze; dhe

3. Fëmijët beqarë që jetojnë në ngarkim të prindërve dhe paraqesin një aftësi të kufizuar fizike ose mendore, por që mund të punojnë, pa u bërë kështu një barrë e shtuar financiare për shtetin pritës, dhe që janë të pajisur me leje qëndrimi të posaçme të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës Franceze.

d) “Aktivitet profesional me pagë” do të thotë: çdo aktivitet që shpërblehet me një pagë të parashikuar në një kontratë pune në përputhje me legjislacionin e shtetit pritës.

Neni 3

Procedurat

a) Punësimi i një personi në ngarkim për të ushtruar një aktivitet profesional me pagë ose vetëpunësimi në shtetin pritës varet nga autorizimi i dhënë paraprakisht nga autoritetet kompetente, nëpërmjet një kërkesë dërguar në emër të personit në ngarkim, nga Ambasada e tij në protokollin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës. Kërkesa duhet të saktësojë aktivitetin profesional që personi në ngarkim dëshiron të ushtrojë, adresën e punëdhënësit të mundshëm dhe çdo informacion të kërkuar gjatë procedurës dhe në formularët e autoritetit përkatës, si dhe shumën e pagës së parashikuar. Autoritetet kompetente të shtetit pritës, pasi verifikojnë nëse personi në ngarkim i plotëson kushtet e nevojshme të parashikuara në këtë marrëveshje, në përputhje me legjislacionin e brendshëm në fuqi, informon zyrtarisht Ambasadën e shtetit dërgues, nëpërmjet protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të shtetit pritës që personi në ngarkim është i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi në shtetin pritës.

b) Pas tre muajsh nga data e marrjes së autorizimit për të ushtruar një aktivitet profesional, Ambasada u dërgon autoriteteve kompetente të shtetit pritës provën që personi në ngarkim dhe punëdhënësi i tij u përgjigjen detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni i shtetit pritës në lidhje me mbrojtjen sociale.

c) Në rastet kur personi në ngarkim dëshiron të ndryshojë punëdhënësin pasi ka marrë një autorizim punësimi, ai duhet të paraqesë një kërkesë të re për autorizim.

d) Në rastet kur personi në ngarkim dëshiron të ndryshojë aktivitetin profesional vetëpunësimi, ai duhet të paraqesë një kërkesë të re për autorizim.

e) Autorizimi për të ushtruar një aktivitet profesional nuk do të thotë që personi në ngarkim është i çliruar nga çdo kërkesë, procedurë ose detyrim që normalisht vlen për këtë punë, qoftë në lidhje me karakteristika personale, me diploma ose kualifikime profesionale ose të tjera. Në rastet kur kemi të bëjmë me profesione të rregulluara, për të cilat autorizimi i ushtrimit mund të jepet vetëm në funksion të disa kriterëve, personi në ngarkim është i detyruar t'i përmbushë këto kriterë.

f) Autorizimi mund të refuzohet në rastet kur mund të punësohen vetëm shtetasit e shtetit pritës për arsye që lidhen me sigurinë ose me rendin publik.

g) Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk kanë të bëjnë me njohjen reciproke midis dy shteteve të diplomave, të nivelit ose të studimeve të kryera.

h) Autorizimi për t'u punësuar, që i jepet një personi në ngarkim të një punonjësi të misionit, është i vlefshëm deri në përfundimin e mandatit të këtij punonjësi ose deri kur përfituesi nuk konsiderohet

më person në ngarkim.

i) Megjithatë, është marrë në konsideratë një afat i arsyeshëm, i parashikuar në nenet 39.2 dhe 39.3 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike dhe nenet 53.3 dhe 53.5 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore. Aktiviteti profesional i ushtruar në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk autorizon dhe as u jep të drejtë personave në ngarkim të vazhdojnë të banojnë në territorin e shtetit pritës, si dhe nuk i autorizon ata ta ruajnë këtë vend pune apo të fillojnë një punë tjetër në këtë shtet pas përfundimit të afatit të autorizimit.

Neni 4

Imuniteti civil ose administrativ

Në rastin e personave në ngarkim, që gëzojnë imunitet nga juridiksioni civil ose administrativ i shtetit pritës, në përputhje me Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 ose të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963, ky imunitet nuk zbatohet në rastin e një veprimi ose mosveprimi të kryer gjatë aktivitetit profesional, si dhe kur ky aktivitet parashikohet nga juridiksioni civil ose administrativ i shtetit pritës.

E njëjta gjë parashikohet edhe në rastin e imunitetit nga ekzekutimi, i cili nuk zbatohet në rast të një padie të lidhur me këtë aktivitet profesional.

Neni 5

Imuniteti penal

Në rastin e personave në ngarkim që përfitojnë nga një imunitet juridik penal i shtetit pritës, sipas Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 ose të asaj mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963 ose çdo tekst tjetër ndërkombëtar i zbatueshëm:

a) Dispozitat në lidhje me imunitetin e juridiksionit penal të shtetit pritës vazhdojnë të zbatohen për rastet e një veprimi të kryer gjatë aktivitetit profesional.

b) Por, në rastet e kundërvajtjeve të rënda, të kryera në kuadrin e aktivitetit profesional, shteti dërgues, me kërkesë me shkrim të shtetit pritës, duhet të marrë në konsideratë seriozisht heqjen e imunitetit të personit në ngarkim të implikuar ndaj juridiksionit penal të shtetit pritës.

c) Heqja dorë nga imuniteti i juridiksionit penal nuk do të ketë të bëjë me ekzekutimin e vendimit. Prandaj është e nevojshme që dorëheqja të jetë e specifikuar. Në raste të tilla, shteti dërgues do të marrë seriozisht në konsideratë heqjen dorë nga ky imunitet.

Neni 6

Regjimi tatimor dhe sigurimet shoqërore

Në bazë të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961 dhe në bazë të dispozitave të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të vitit 1963, për personat në ngarkim zbatohet legjislacioni përkatës në lidhje me regjimin tatimor dhe sigurimet shoqërore të shtetit pritës, për sa u përket aktiviteteve të tyre profesionale me pagë në këtë shtet.

Personi në ngarkim i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional, nuk përfiton, duke filluar nga data e autorizimit, nga lehtësirat doganore të parashikuara nga nenet 36 dhe 37 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike, nga neni 50 i Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore ose nga marrëveshje që kanë të bëjnë me selinë e organizatave ndërkombëtare.

Personi në ngarkim, i autorizuar të ushtrojë një aktivitet profesional sipas kësaj marrëveshjeje, mund të transferojë të ardhurat dhe fitimet dytësore në të njëjtat kushte, siç parashikohet nga rregullorja e shtetit pritës për punonjësit e huaj.

Neni 7

Ushtrimi i një aktiviteti vetëpunësimi

Në rastin e një aktiviteti profesional vetëpunësimi, kërkesat e personave në ngarkim për të ushtruar këtë lloj aktiviteti profesional shqyrtohen, rast pas rasti, në përputhje me dispozitat ligjore

dhe rregullat e shtetit pritës.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj marrëveshjeje, zgjidhet me negociata të drejtpërdrejta mes Palëve në rrugë diplomatike.

Neni 9

Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe përfundimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, me anë të të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën në lidhje me përfundimin e procedurave kushtetuese dhe ligjore të brendshme të nevojshme për miratimin e saj.

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me miratimin reciprok të Palëve. Ndryshimi hyn në fuqi sipas afateve të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi për një afat të pacaktuar. Megjithatë, ajo mund të zgjidhet në çdo moment nga njëra nga Palët, me shkrim dhe në rrugë diplomatike. Në këtë rast, ajo përfundon 6 (gjashtë) muaj pas kërkesës për zgjidhjen e saj.

Bërë në Tiranë, më 19.9.2016, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhët shqip dhe frëngjisht, të dyja versionet të barasvlershme ligjërisht.